

## PARALELE FRAZEOLGJIKE MIDIS TË FOLMEVE TË SHQIPES E MAQEDONISHTES A PHRASEOLOGICAL PARALLEL BETWEEN ALBANIAN AND MACEDONIAN VERNACULARS

MUSTAFA IBRAHIMI

Universiteti i Europës Juglindore, Tetovë, Maqedoni

Email: m.ibrahimi@seeu.edu.mk

AKTET VI, 4: 478 - 480, 2013

### PERMBLEDHJE

Paralelet leksikore dhe frazeologjike, jo vetëm midis shqipes dhe maqedonishtes, por edhe me gjuhët e tjera të Ballkanit janë bërë përmes një baze mjaft të gjerë dhe nëpër shumë shekuj. Si më kryesore paraqitet simbioza dhe interferenca shumëvjeçare gjuhësore. Ky nivel gjithnjë është pjesa më e hapur dhe më labile e një sistemi gjuhësor, andaj edhe huazimet gjejnë vend më të theksuar. Në rrethana të tilla janë gjetur edhe të folmet shqipe dhe ato maqedonase. Këto paralele frazeologjike paraqiten në të gjitha shtresat leksikore, si nga jeta materiale, ashtu edhe nga ajo shpirtërore. Praninë e kaq shumë paraleleve frazeologjike midis të folmeve shqipe e të folmeve maqedonase e ka mundësuar kontakti direkt dhe bashkëjetesa e gjatë midis të dy popujve. Si objekt, studimi i yni do t'i ketë frazeologjizmat në të folmet e tyre.

**Fjalë kyce:** frazeologji, shprehje, huazime, të folme, shqip, maqedonisht..

### SUMMARY

Lexical and phraseological parallels between Albanian and Macedonian language, but also between other Balkan languages, are made through a wide base and through many centuries. The perennial language symbiosis and interference is presented as most important that was manifested on all language levels, especially on the lexical and phraseological level. This level is more open and labile part of a lingual system. Albanian and Macedonian have borrowed words from each other as a result of direct contacts. These borrowings are presented in all lexical strata, in both material and spiritual life as well. Our object of study will be the phraseologies Macedonian and albanian language. As the object of our study will be frazeologjizmat in Albanian and Macedonian dialects in Macedonia, making parallels between them.

**Key words:** phraseologisms, interferences, proverbs, lending, vernaculars.

---

### HYRJE

Gjuha e shkruar dhe e folur në zhvillimin e saj shënon edhe përdorimin e njësive frazeologjike. Njësitë e tilla frazeologjike, përveç që dëshmohen tek autorët e vjetër të letërsisë sonë, ato i gjejmë edhe në gojën e popullit. Si objekt kryesor i kësaj kumtese mbeten konkordancat në lëmin e frazeologjizmave gjuhësore midis shqipes dhe maqedonishtes, që nuk duhet parë si përputhje njësisht të veçara dhe të rastit, por si paralele tipash, llojesh, kategorishë.

Paralelet leksikore dhe frazeologjike, jo vetëm midis shqipes dhe maqedonishtes, por edhe me gjuhët e tjera të Ballkanit janë bërë përmes një baze mjaft të gjerë dhe nëpër shumë shekuj. Zhvillimi i këtyre, para së gjithash i detyrohet një sërë faktorësh ekstralinguistik, në mesin e të cilëve si më të rëndësishëm janë: raportet dhe kushtet kulturo-historike dhe shoqërore në të cilat janë zhvilluar këto gjuhë. Si më kryesore paraqitet simbioza dhe interferenca shumëvjeçare gjuhësore, e cila është manifestuar

në të gjitha nivelet gjuhësore, e veçanërisht në nivelin leksikor e frazeologjik. Ky nivel gjithnjë është pjesa më e hapur dhe më labile e një sistemi gjuhësor, andaj edhe huazimet gjejnë vend më të theksuar.

Në rrethana të këtilla sociolinguistike janë gjetur edhe të folmet shqipe dhe ato maqedonase, kryesisht nëpërmjet kontakteve të drejtpërdrejta, duke pranuar e dhënë me njëra tjetrën. Këto paralele frazeologjike paraqiten në të gjitha shtresat leksikore, si nga jeta materiale, ashtu edhe nga ajo shpirtërore. Prandinë e kaq shumë paraleleve frazeologjike midis të folmeve shqipe e të folmeve maqedonase e ka mundësuar kontakti i drejtpërdrejtë dhe bashkëjetesa e gjatë shumëshekullore midis të dy popujve. Si objekt studimi artikulli ynë do të sheshojë vetëm një fushë të gjuhësisë – frazeologjizmat në të folmet e tyre.

### 1. Togfjalëshi i lirë frazeologjik

Kjo formë shërben për krijimin e njësisve frazeologjike duke rritur fondin e përbashkët të frazeologjizmave të këtyre gjuhëve. Në këto lloje të togfjalëshave frazeologjike mund të vërehet se foljet komponente janë nga grupi i foljeve më të zakonshme dhe me strukturë të gjerë semantike. P.sh. *Har gojën – отвора уста, fus hundën – пика нос, ka gisht – има прст, har sytë – отвора очи, ngre krye – крева глава,*

### 2. Analogjia tipologjike

a) Analogjia tipologjike mbetet me vlerë edhe atëherë, kur ndonjë nga gjymtyrët e frazeologjizmit të shqipes ka si koresponduese të veten një fjalë me kuptim tjetër leksikor. Le të krahasohen shembujt: *i hedh hi syve – му фла пепел во очите, i lëpij këmbët – му ги лиже нозете*

b) Me këtë tip të njësisve frazeologjike lidhen edhe frazeologjizmat që e ruajnë idenë e krahasimit. Edhe në këtë kategori shqipja dhe maqedonishtja gjejnë analogji midis tyre, p.sh. *(dukem) si pulë e lagur:: (изгледам) како мокра кокошка; rri mbi ferra: седи како во трње; e di ujë – вода го знам; Bluan si mulli i prishur: flet shumë – и меле воденицата - ме ле воденицата (KG-166).*

### 3. Frazeologjizma me kuptim të figurshëm

Shqipja me maqedonishten, por edhe me gjuhë të tjera të Ballkanit gjejnë paralele edhe me frazeologjizmat që formohen nga një fjalë me kuptim të drejtpërdrejtë dhe nga një fjalë me kuptim të figurshëm, p.sh.: *i zë besë / besoj: му верува; zjarri e djegtë (digjet): оган да го изгоре, mblihd mendjen: собери си го умот; i fus frikën – му сеам страв; i ngul sytë – вперам очи.*

### 4. Paralele frazeologjizmash të tipit emëror, mbiemëror e ndajfoljor

Shqipja gjen paralele edhe për tipat emërore, mbiemërore dhe ndajfoljore, si: *S'ka parë ditë të bardhë – не видел бел ден; më sallë me dy faqe - дволична лопата; me gojë të hapur - со полна уста; Budalla nuk ka bripa: i çmenduri nuk ka shenja të posaçte – Будалиот нема розој (NPGSS-21).*

### 5. Paralele frazeologjizmash të tipit foljor

Paralele midis shqipes dhe maqedonishtes kemi edhe në të gjitha modelet e tipit foljor të frazeologjizmave. P.sh.: Folje + emër: *bëj çudi – прави чудо; bëj shaka - прави шега; Von sabër: qetësohet – Дай си – сабур (KG-159); E qiet bukën: vetë punon – Сј-о-ваде лебо (KG-194).*

### 6. Frazeologjizmat me fjalë semantiksht korelative

Një tip interesant nga struktura në të cilën shqipja gjen analogji në gjuhë të tjera të Ballkanit, përbëhet nga frazeologjizmat me shkallë të ndryshëm njësimi semantik dhe idiomatizimi, që formohen me anë të përsëritjes së një fjale, ose me bashkimin e dy fjalëve semantiksht korelative (sinonime dhe antonime), psh. *Ditë për ditë – од ден на ден; sy në sy – очи воочи; krah për krah: рамо до рамо; brez pas brezi – од поколение до поколение; Diftem tët difte: nuk e di – Каж-ми, да-т-кажум (KG-169).*

Për shumë frazeologjizma të shqipes s'kemi mundur të gjejmë paralele frazeologjike të të njëjtit tip në gjuhë të tjera të Ballkanit, p. sh. *Zë ngojë, shes mend, më shkon fjala, e bën bisht etj.*

## II. Njësi frazeologjike me strukturë fjalie

Njësi frazeologjike me strukturë fjalie janë më të pakta. Përbëhen zakonisht nga dy gjymtyrë dhe nisin me një fjalë përemërore, shërbyese etj. Ato hyjnë në fjali si të ishin një njësi e vetme. Këto njësi frazeologjike mund të ndahen në tre nëngrupe:

1) Shprehje frazeologjike që përdoren si njësi e vetme: *I përveshi mangët* - 'ka filluar të punoj; *Vendi-ven se zen* - 'është nervoz'.

2) Në nëngrupin e dytë bëjnë pjesë **fjalët e urta, proverbat etj**, të cilët i shprehin veçoritë specifike të jetës popullore, përmbajnë urtësi që është fituar nga përvoja e shumë gjeneratave dhe janë të lidhura ngushtë me jetën e përditshme dhe manifestimet ditore: *Ekri tretet nier ku osh i nxit* - 'gjithçka kryhet me kohë': *железото се кове додека е жешко*; *Kush s'ka ke kraja da ket ke kamët* - 'kush nuk është i mençur, vuan': *кој нема во главата же има во нозете*; *Çil bunar i ri, po ke i vietri to bishtay* - 'mos i harro miqtë e vjetër' - *отвори нов бунар, ама во стариот не плукај*; *Dardha bie nën dardhën* - 'Si janë prindërit ashtu janë edhe fëmijët - *Крушата под круша паѓа*; *Nuk është secilën ditë Bajram*: Секуј ден неј Вилигден (KG-192).

### Përfundim

Sa i përket shkallës së produktivitetit të këtyre tipareve, secila gjuhë ka veçoritë e saj, megjithatë shqipja më tepër ofron me rumanishten, bullgarishten dhe maqedonishten, shumë pak me serbishten dhe turqishten. Këto analogji tipologjike që dalin me gjithë gjuhët e Ballkanit, veçanërisht me maqedonishten përbëjnë anën e brendshme, thelbësore të bashkësisë ballkanike në lëmin e frazeologjisë.

### Bibliografia

ÇABEJ, Eqrem (1956), Parallele Ausdrucke und Redensarten in den Balkan-sprachen: *Revue internationale des etudes Balkaniques* I, Beograd.  
 IBRAHIMI, Mustafa (2007), *Fjalë dhe shprehje popullore nga rrethi i Prilepit, Krushevës dhe Velesit*. Interlingua: Shkup 2007.  
 ISMAJLI, Rexhep (1972), *Disa fjalë shqipe në maqedonishte*, GJA,SSH, Prishtinë.

KABOEV, Филип (1961), *Народни пословици и гатанки од Струга и Струшко* (NPGSS), Скопје.

MURATI, Qemal (1986), *Frazeologjizma dhe shprehje të reja nga goja e popullit*. "Gjuha shqipe" 2, Prishtinë.

NESIMI, Remzi, *Disa elemente shqipe në të folmen e maqedonishtes perëndimore*

OSMANI, Zihni (1997), Frazeologjizmat në të folmen e Prespës: "Jehona" Shkup, 6/7: 94-104.

ПЕЕВ, Коста (1968), Белешки за лексиката и frazeologijata од Струмичко: "Македонски јазик" XIX: 201-225.

ПЕЕВ, Коста (1968), Фраzeолошки изрази во македонскиот јазик: "Македонски јазик" XVIII: 201-225.

ПЕЕВ, Коста (1987, 1988), *Кукушкиот говор* (KG). Книга I, II, Скопје.

POLOSKA, Agim (1997), Frazeologjizmat në të folmen e Prespës: *Jehona*, Shkup, 6/7: 94-104.

СТОМАТОСКИ, Т. (1965), Белешки за frazeologijata на нашиот јазик: *Литературен збор*, XII, 6, Скопје.

THOMAI, J., LLOSHI, Xh., HRISTOVA, R., QIAZITI, K., MELONASHI, A. (1999), *Fjalor Frazeologjik Ballkanik*. Tiranë.

THOMAI, Jani (1989), Rreth leksikut dialektor e krahinor të shqipes: *Studime filologjike*, 1 Tiranë.

THOMAI, Jani, Xhevat Lloshi (1990), Paralele frazeologjike të shqipes me gjuhë të tjera të Ballkanit: *Studime filologjike*, 1, Tiranë.

X x x x (1992), *Македонски народни умотворби од Кичевско*. Кичево.

X x x x (1992), *Македонски народни умотворби од Разлошко*. Скопје. .